



Lebit Murtishi

*Këtu jam
Që sot e mot
(poezi)*

Arbëria

Autori:
Lebit Murtishi

Redaktor:
Zekë Krasniqi

Përgatitja kompjuterike:
Kadri Sherifi

Kopertina:
Kadri Sherifi

Shtypi:

Tirazhi: 1000 copë

Lebit Murtishi

Këtu jam

Që sot e mot

(poezi)

Cikli i parë

I

„Gjurmët e etërve të mi“

- 1) Karadak
- 2) Gjallë është kënga juaj
- 3) Këtu jam që sot e mot
- 4) Vetëm një agim
- 5) Udhës tonë
- 6) Sharr
- 7) Atdhe
- 8) Me këmbë pëlqeve të vdesësh
- 9) Elegji

Karadak

Këtu janë
Gjurmët e etërve të mi :
Këngët,
Lotët,
Plagët.
Këtu janë
Gjurmët e etërve të mi
Plakur
E thinjur
Pa rini.

Këtu,
ka dhe varre fëmijësh
Pa fëmimi.
Ja,
këto janë varret e pasardhësve
Të etërve të mi
Lindur
E vdekur
Pa fëmimi.

Ja,
Këtu vdiset
Pa diell në gji,
Pa këngë lulesh,
Pa fëmini.

Ja,
Këto janë gjurmët e etërve të mi
Plakur e thinjur pa rini.

Ja,
Këtu vdiset për Shqipëri...

19.10.2005

Bern

Gjallë është kënga juaj
(dëshmorëve)

Kënga juaj është gjallë;
Nën plisat e tokës
Ku bari i njomë gufon,
Në brigjet me valë
Ku deti i kaltër vlon...

Gjallë është ajo këngë
Nën Qiellin arbëror,
Kur toka ka dhimbje
Zbret si meteor...

Herë vjen si pranverë
Veshur me blerim,
Herë shpërthen bujshëm
Kur Qielli ka gjëmim...

Gjëmon mbi planete
Ku botë e shthurur vdes,
Gjëmon kur pranvera
E kuqe buzëqesh.

Gjallë është kënga juaj...

27.10.2005
Bern

Këtu jam që sot e mot
(Karadak)

Këtu jam që sot e mot.
Kështu këndon Karadaku
Një këngë të larë në lot,
Këtu bie erë gjaku
Në çdo derë në çdo portë.

Shkab` e lasht` e Skënderbeut
Mbi qemer të çdo shtëpie
Erë gjaku bie dheu,
Bie erë Shqipërie.

N` Orizare, Komandanti
Qysh prej shekujsh rri më këmbë,
Gjoks e brez me rrethatore,
Armatosur gjer në dhëmbë.

Në Hotël – pëllëmbë e varre,
Erë baruti bie dheu,
Shkrumbëzuar gurë e pragje,
Është kohë Skënderbeu.

Mbi Sllupçan, tek gjëmë e madhe
Të përjetshëm ndritin yjtë,
Tek Zymberajt dhe Jasharët
Shqipërisë ja falin bijtë.

Këmbëkryq Komandant Tigri
Në Vaksincën kryelartë,
Mban konakun Kryetrimi
Përbri gjyshërve të lashtë.

Këtu jam që sot e mot.
Kështu këndon Karadaku
Një këngë të larë në lot,
Këtu bie erë gjaku
Në çdo derë, në çdo portë...

Gusht – Tetor 2005

Vetëm një agim...

Vetëm një agim
Me këngë ta pres,
Pak ajër lirie
Të thith dhe të vdes.

Vetëm një agim
Me këngë ta pres...

27.10.2005

Bern

Udhës sonë...

Udhës tonë të pasosur
I ngrenë diga i vënë leqe,
Na mallkon botë e marrosur
Po s`i thamë: lepe-peqe.

Lepe-peqe, siç i thanë
Njëherë moti ca surratë,
Ca hasanë ca rrahmanë
Dhe ca palo -„demokratë“.

Hiq nga mendja botë-kurvë
Lepe-peqe-temenanë,
Se kanë vdekur ka qëkur
Me hasanë me rrahmanë.

17.11.2005

Bern

Sharr

Rrjedhin shekujt tatëpjetë,
Ti plisbardhë-kokëpërpjetë,
Ballë për ballë me erën vetë
Kokën lartë përmbi retë,

Qëkur lindi bota vetë.

16.11.2005

Bern

Atdhe

Të kuqe pranverat
I mbajte Atdhe,
Të kuqe
Këmishën
Ndër shekuj të pafre...

E kuqe fëmijëria
Ndër breza vigjilon,
E kuqe
Pikë e djersës
Në ballë si medaljon...

E kuqe
Pikë e lotit
Të nënave në prag,
Që presin me një ëndërr
Në shpirtin copë e plagë.
Atdhe...

T`i ndiej rënkimet
Mbi
E ndër dhè,
T`i ndiej dhe këngët
Si shpërthejnë Atdhe...

Jam diku unë
Se diku
Ti je
I shenjti Atdhe

Erën e sofrës
Ta ndiej Atdhe,
Koret,
Thërrimet
Të lara me lotë
I ndiej Atdhe...

Mijëra plagë
Mban në gjoks
Pse s`u mësove
Të thuash:
SOS...

Vetëm Ti,
Vetëm Ti
Varrin e trimit
Njeh për stoli...

Vetëm Ti
E puth me mallë
Atë që plumbin
Pret në ballë.
Atdhe...

Korrik 2005

Më këmbë pëlqeve të vdesësh
(dëshmorit-Naser Hani)

Deshën hijenat, mes sheshit
Më gjunjë ta ulin qëndresen,
Deshën në prag të mëngjezit
Të gjallë ta lidhin Veleshtën.

Dorëzohu! të thanë hijenat,
Dorëzohu! Qëndresë Dardane,
Dhe ngulën në gjoks të Veleshtës
Ca dhëmbë hijenat barbare.

Po ti më këmbë qëndrove
Si Rrapi i Lashtë i Veleshtës,
Më këmbë pranverat i shkove,
Më këmbë pëlqeve të vdesësh.

24.12.2005
Bern

Elegji

(dëshmorit-Nuri Mazari)

Të qanë nënat strugane,
Të qanë me lotë nëne,
Trim-trimosh i kësaj ane
S`e mban gjiri dhimbjen tënde;

Të qanë motrat strugane,
Të qanë me lotë motre,
Trim-trimosh i kësaj ane
Plagë-Shpirti plaga jote;

Të qanë nuset strugane,
Mbushet lotë valë e Drinit,
Trim-trimosh i kësaj ane,
Ti hero i Dukagjinit;

Kur ta puthi ballin nëna
Lotë gjaku derdhi qielli,
Kur t`i puthi plagët nusja
Psherëtiu poshtë dheri;

„Mos më qani - pate thënë
Nëse bie ndonjë ditë,
Se një besë e kam dhënë
Shqipërisë t`i bëhem dritë”.

16.11.2005

Bern

Cikli i dytë

II *„Ky shi”*

- 1) Udhët e mia
- 2) Ky shi
- 3) Dëshirë
- 4) Mall
- 5) Puthje toke
- 6) Kam mall
- 7) Ka ditë
- 8) E vdekur ke qënë
- 9) Se jam i marrë
- 10) Tivar
- 11) Kërkoni
- 12) E zgjodha vet këtë udhë

- 13) Te „Kalldrëmi“
- 14) Prespë
- 15) Shtegtim
- 16) Guri i Gjyshit
- 17) Ladorisht
- 18) E pabesueshme
- 19) Jam
- 20) Migjeniane
- 21) Rrëmuje Shpirti
- 22) Këngë e jetës
- 23) Dielli im
- 24) Epigram
- 25) Henri Murger
- 25) Tha i ligu

Udhët e mia

Udhët e mia kujtoj një çast,
Udhët që shkela dikur më këmbë,
Kur ditët s`kishin diell mjaft
Dhe netët s`kishin hënë...

Tash këmbët po më lënë ngadalë
Dhe forca po më shteret,
Ndaj po të vdes pa lënë një fjalë
Mos thoni „iku heret“...

15.11.2005

Bern

Ky Shi

Kjo këngë Qielli
Pa harmoni
Si gjemb i egër
Më ther në gji.

Më hedh në prehër
Të fëminisë
Ku fle nën strehë
Fill i magjisë.

Baladë Qielli
Është ky shi
Dhe këngë loti
Në sytë e mi...

Ky shi...

13.05.2005

Bern

Dëshirë

Sikur të bëhem ndonjëherë
Një dallgë lumi që shungullon,
Brigjet e bardhë do puth përherë
Kur këngë e mallit ze e gjëmon...

Sikur të bëhem vetëm njëherë
I ri, me gaz e me humor,
Do dal në mal me maliherë
Të pres tufanët në kraharor...

Ah, sikur, sikur...

17.09.2005

Bern

Mall

Ky Qiell
Sa hipokrit
Qan me lot
Dhe i fsheh sytë!

Ndërsa unë
Mbuloj lotin
Edhe kur flas
Veç me Zotin!

Nuk e di
Kush fsheh më shumë
Qielli lartë
A poshtë unë.

31.08.2000

Bern

Puthje toke

Hapin e parë po bëja në jetë,
hapin e ardhshëm po kërkoja unë,
Ecja mbi tokë si zogë pa fletë
Dhe rashë mbi një gur theva
dhëmbë e hundë...

Ajo ishte puthja ime e parë
Kur balli i njomë më preku në tokë,
Dhe puthje të tillë kurrë më s`kam
marrë,
Askush më s` më puthi në ballë
aq ngrohtë...

01.11.2005
Bern

Kam mall

Për gjuhën e zogjëve
Nën qiellin e zjarrtë,
Për këngët e moçme
Dhe fjalën e artë...

Kam mall për pragun
Ku pleqtë kanë shkelë,
kam mall dhe për vargun
Që porta shpirti çel...

11.09.2005

Bern

Ka ditë

Ka ditë që nuk bëj lutje,
Ka ditë që s`them një fjalë,
Ka ditë që me sy hapur
Ëndrrat më sjellin vërdallë...

Ka ditë që lutem shumë,
Ka ditë që lutem pak,
Ka ditë që vet Profetët
Derdhin nga një pikëz gjak...

13.11.2005

Bern

E vdekur ke qënë

Ti
Hije e zezë
Gjithnjë
E vdekur ke qënë,
Edhe kur jetën ke ndjekur
Nga pas t`i ngulësh ca dhëmbë,
E vdekur ke qënë...

13.11.2005

Bern

Se jam i marrë

Se jam i marrë
O miqë, jam,
Se njëmijë ëndrra
Brenda kam.

Se plot njëmijë
Kam në gji,
Askush, asgjë
Për to nuk di...

Janë plot njëmijë
O miqtë e mi...

14.11.2005
Bern

Tivar

Dje,
Në breg të detit
Si një margaritar,
Sot,
Një gur i heshtur
I ftohtë si varr !

O barka
Që rënkoni
Nën ujët qelibar,
Pse s`ndihet asnjë këngë
Në këtë heshtje – Varr!

Ah! Tivar,
Dje
Dhe sot
E kanë një Nesër
Kur ti do zgjohesh
Me këngë – Patjetër...

01.02.2006
Bern

Kërkoni...

Rrugët për tek dielli që çojnë,
Rrugët e mundimshme të gjata
e me dhimbje,
Kërkoni kohë më kohë,
Në muzg e në agim;
Kërkoni pa u lodhur
Se koha s`ka pushim,
Bluan gur e strall,
Të shkel e të përdhos
Me faj edhe pa faj...

Kërkoni...
Rrugët për tek dielli që çojnë,
Se koha s`ka mëshirë,
Kërkoni sa s`është vonë,
Me hir e me pahir...

01.02.2006

Bern

E zgjodha vet këtë udhë

E zgjodha vet këtë udhë të gjatë
Se dua duke ecur diku të vdes,
S`dua të dergjem në shtrat
si i ngratë
Dhe vdekjen me ëndrra me lule
ta pres.

Jo,
Vdekja të më gjejë udhës dua,
Të bëj një copë udhë me të
duke qeshur,
Që të mos thonë të vdekurit për mua
„Vdiq një kufomë që moti kish
vdekur“.

20.12.2005

Bern

Te „Kalldrëmi“

Në fshatin tim, një rrugë e vjetër
Nuk di pse quhet „kalldërma“
Atje as gurë as bar s`ka mbetur,
Atje as rrugë as shteg nuk ka...

„Kalldrëmi“ shkretë nuk lëshon zë,
S`ka më fëmijë as bagëti,
Ikën e ikin e s`vijjnë më
Dhe qan „kalldrëmi“ si t`ish njeri...

Dhe qajnë gurët poshtë nën bar,
Dhe heshtin gjurmët në „kalldërma“,
Dhe qan mbi gurë bari i tharë,
As rrugë as shteg atje më s`ka...

20.12.2005

Bern

Prespë

Më shkon mendja shpesh
Në kopshtet me mollë
Tek kënga me nëntë
Shtrohej hollë – hollë...

Sot, pamje të shkreta
Më shfaqen - për drejt,
Tek shoh të kërrusur
Rrugëve ca pleq...

Prespa ime e dashur
Nga mendja s` të heq...

16.11.2005
Bern

Shtegtim!

Ikin zogjtë!

Qiejve kërkojnë
Një ëndërr të fikur.

Ikin zogjtë,
Po dhimbjen ma shtojnë
Ca zogj të parritur
Që s`dijnë ku shkojnë...

09.09.2005

Bern

Guri i gjyshit 1)

Tek ky shkëmb, si qiell i murrmë
Që erë vjell e mbjell furtunë,
Enigmë e lashtë fle diku
Tek ndenjën pleqtë gju më gju.

Tek ndenjën shtruar pleqtë e thinjur
Mbështetur kokën tek ky gur,
Duhan të ashpër tek kanë thithur
Pleqtë e moçëm këtu dikur.

Këtu thithën hidhërimin
Se gëzimi vinte rrallë,
Këtu puthej me thëllimin
Brazdë e rrudhave në ballë.

Si vrojtues qëndron sot
Guri, lart mbi Zagraçan, 2)
S` e lëvizi kurrë nga rrënja
As rebesh dhe as tufan...

13.11.2005

Bern

1) Gur mbi fshatin Zagraçan, ku mblidheshin Pleqtë dikur dhe qanin hallet për raste të ndryshme.

2) Zagraçan, fshat i Strugës.

Ladorisht

Sërish,
Në prehërin tënd
Erdha frymë të marr
E plagët të t`i prek.
Erdha,
Se pranë teje
Jam Zeusi vet...

Sërish,
Në pragun tënd
Pas vitesh të tretur
Unë kokën po mbështes.
Erdha,
Se largë teje
Nuk munda as të vdes.
Ladorisht...

01.02.2006

Bern

E pabesueshme!

Kam,
Dy zemra në gjoks,
Të dyja
Të mbushura plot;

Njëra si kupë me helm,
Tjetra si kupë me lot...

14.11.2005

Bern

Jam

Jam

E vazhdoj të jem,

Jo për inat të dikujt,

Jam se më pëlqen të jem

Nga një çikëz i gjithkujt...

13.11.2005

Bern

Migjeniane

Sonte ka festë.

Gjëmon këngë e lëmoshës
Mbi sofrën e mykur.

Shpresën e ëndërrt
Shtron në sofër
Një bark i uritur.

Sonte këndohet
Këngë e lëmoshës
Dhe shfryjnë mbi sofër
Dhimbjet e botës...

Sonte dikush
Feston vërtet
Po barkurituri
Ëndrën pret.

O Barkurituri,
O bir fakiri,
Në brigje ëndrrash
Që shpresën pret,
Zgjo madhështinë në vehten tënde
Se ditë e nesërme të përket...

03.11.2005

Bern

Rrëmuje Shpirti

Mbushur me shafran
Kazani Shpirtit,
Etur
Sytë e lodhur
Për një lot,
Kërkon gjysmëshpirti gjysmëtrupin
Dhe s`e gjen të plotë
Kund, o Zot!

31.10.2005

Bern

Këngë e Jetës

Koha rrjedh si fërfërimë,
Shuhen ëndrrat një nga një,
Ik e fundit psherëtimë
Dhe vjen një ditë e s`jemi më.

Lart me heshtjen në amshim
Tretet kënga si magji,
Si gjeth i rënë që s`fërfërin
Kur erë fryn e bie shi...

10.10.2005

Bern

Dielli im

Të ndiej
Dielli im
Ngadalë si perëndon
Dhe këngën që po shuhet
Në Shpirt si më rëndon...

Gusht 2005
Bern

Epigram

Mos thoni vdiq për mua
Në varr kur të më shtrini,
As ndjesë pastë mos thoni
Se më rëndon qefini.

Vdekja ime s`është vdekje
Edhe pse ballin ma puthi,
Është hiri i jetës
Që mbyll kapakun së fundi...

27.06.2000

Bern

Henri Murger

„ Veç qeni le të qajë
për mua kur të vdes “,
E thotë një baqladë e vjetër
Nga një poet i ndjerë francez.

Anri Myrzhe është ky emër
Që nëmi etjen për lavdi,
Vjen ky poet nga botë e vjetër
Dhe sot më bëhet mik i ri.

12.02.2006

Bern

Tha i ligu...

Edhe unë
Tha i ligu
Kam pak erz
Dhe pak fytyrë...

Por harroi
Derëziu
Se, dhe derri
Ka fytyrë,

Por e ka
Një çik të ndyrë...

13.11.2005
Bern

Cikli i tretë

III

„Tinguj nate“

- 1) Tinguj nate
- 2) Ëndërrim
- 3) Nata ka dhimbje
- 4) Se malli më mori
- 5) Kujtesë
- 6) S` këndoj më

Tinguj nate...

Fle lumi nën këngë dallgësh,
Fle gjethi nën fërfërimë,
Fle hëna në sytë e vashës,
Fle dhimbja nën drithërimë.

Këta tinguj, çmendurisht
Po më zgjojnë një mall të rrallë,
Zjarri hershëm thellë në Shpirt
Sikur ndizet mengadalë...

28.10.2005

Bern

Ëndërrim

Një yll prej yjeve u nda,
Një yll prej qiellit u këput,
Dhe m`u në kraharor më ra
Dhe m`u në gji si zjarr m`u fut!

Një yll në kraharor më ra
Nga degë e qiellit hyjnor,
Se ç`copë dogji e ç`copë la
Askush s`e di veç zemër e gjorë...

14.11.2005

Bern

Mesnatë!

Pushojnë
Në këtë orë
Sytë e saj të ëmbël,
Sytë e mi
Të gjorë
Zgjuar shohin ëndërr!

16.11.2005

Bern

Nata ka dhimbje...

Nata hesht
Se dhimbje ka,
U fsheh hëna
Më s`e pa.

Mermë natë
Ti nën gunë,
Hënë time
Pres dhe unë...

Mermë pak
Në s`të prish punë
Një dhimbje
Në gji më shumë.

20.10.2005

Bern

Sikur...

Një dritëz hëne sikur të jem
Në sytë që s`i zë gjumi,
Kur erë e natës fërshëllen
Në breg të ndonjë lumi...

Të rri si shenjt` mbi ndonjë gur
Prej botës i haruar,
T`i shoh të qeshur si dikur
Dy sy të dashuruar...

10.10.2005

Bern

Se malli më mori...

Zgjo këngën, kitarë,
Që fle nën kujtime,
Se Shpirti ka zjarrë,
Shpirti ka gjëmime.

Zgjoma sonte këngën
Që fle kur e kur,
Ndoshta sytë e lodhur
Qeshin si dikur...

Zgjo këngën e Shpirtit,
Të shkrehem në vaj,
Se malli më mori
Të shoh sytë e saj...

15.10.2005

Bern

Kujtesë

Në kopshtin tim
U fik kandili
Dritë e yjve s`pikon më,
Veç kjo erë trëndafili
M`i zgjon ëndrrat
Një nga një...

04.11.2005

Bern

S`këndoj më...

S`këndoj më për dashuri,
Ajo më nuk më përket,
Ndonëse sytë e saj të zi
Më sëmbojnë zemrën shpesh.

S`këndoj më për dashuri,
S`kam më kujt t`i them „të dua“
Ndonëse sytë e saj të zi
Do më zgjojnë nga varri mua.

13.11.2005

Bern